



# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla I / 3

## MOBILIZIMI I DIASPORËS PËR ZHVILLIM

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit





# PLAN

për zhvillim të qëndrueshëm.

Shtylla I / 3

## MOBILIZIMI I DIASPORËS PËR ZHVILLIM

Analizë politikash në mbështetje të  
procesit të elaborimit të SKZH-së

Zyra për Planifikim Strategjik  
e Zyrës së Kryeministrit

.....

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	4
Thekset kryesore nga kjo analizë .....	5
Qëllimi .....	6
Arsyetimi .....	6
Analiza e situatës .....	6
Politikat aktuale .....	11
Definicioni i problemit.....	13
Zgjidhjet potenciale të bazuara në praktikat më të mira .....	14
Shfrytëzimi i granteve korresponente: Meksika dhe Moldavia.....	14
Ngritja e institucioneve efektive të diasporës: çka funksionon?.....	16
Tërheqja e diasporës së kualifikuar: MIDA, TOKTEN dhe programet e vendeve të qëndrimit .....	18
Rekomandimet .....	19
Stimulimi dhe lehtësimi i investimeve të diasporës.....	19
Themelimi i një skeme të granteve korresponente .....	20
Prioritetizimi i bizneseve të diasporës në Instrumentin e Kosovës për Përkrahjen e Kredive (IKPK) dhe Skema e Kuponëve (SK).....	21
Krijimi i një kornize institucionale efektive për angazhimin e diasporës.....	22
Lehtësimi i mundësive për angazhim afatshkurtër për diasporën me kualifikime të larta.....	23
Tabela e figurave.....	25
Lista e tabelave.....	25
Referencat .....	26

.....

## **Lista e shkurtesave**

PKB –Produkti Kombëtar Bruto

MD – Ministria e Diasporës

KIESA – Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

IOM –Organizata Ndërkombëtare për Migrim

MPI – Instituti për Politika të Migrimit

ECIKS – Iniciativa Ekonomike për Kosovën

MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme

IGF –Fondi Ndërkombëtar i Garancive

SKK – Skema e Këshillimit me Kuponë

NMVM – Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme

NVM – Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

MTI – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

USAID – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

IME – Instituti për Meksikanët Jashtë Vendit

MIDA – Migrimi për Zhvillim në Afrikë

TOKTEN – Transferi i Dijes nëpërmjet Shtetasve të Mërguar

GIZ – Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar

CIM – Qendra për Migrim dhe Zhvillim Ndërkombëtar

DSS – Shërbimi për Përkrahjen e Diasporës

IKPK – Instrumenti i Kosovës për Përkrahjen e Kredive

HEP – Programi për Angazhim të Atdheut

UNV – Vullnetarët e Kombeve të Bashkuara

---

## Thekset kryesore nga kjo analizë

- *Diaspora e Kosovës është një shpëtimtare tradicionale financiare për vendin dhe mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e saj afatgjatë. Sidoqoftë, një pjesë e madhe e potencialit të saj financiar dhe njerëzor mbetet e pashfrytëzuar.*
- *Angazhimi i diasporës në ekonominë e Kosovës has në pengesa nga rreziqet financiare ndaj investimeve, rrjedhës së dobët të informatave dhe lehtësimit të shërbimeve dhe një problemi të veprimit kolektiv i cili rezulton nga fragmentimi politik dhe mosbesimi në institucionet e Kosovës.*
- *Sistemi institucional për zhvillimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve është joefektiv dhe ka nevojë për t'u riorganizuar duke ia lënë hartimin dhe koordinimin e politikave një komiteti ndërministror dhe duke e centralizuar ofrimin e shërbimeve në një departament (Shërbimi i Përkrahjes së Diasporës) me prezencë në terren në vendet ku gjendet diaspora.*
- *Investimet e diasporës duhet të nxitin nëpërmjet një skeme të granteve korrespondente dhe duke i dhënë prioritet ndërmarrësve të diasporës në skemat e tjera të përkrahjes. Transferimi i aftësive duhet të inkurajohet nëpërmjet subvencioneve për detyra afatshkurtra nga pjesëtarët e diasporës me aftësi shumë të larta dhe grante për aktivitet pasuese. Angazhimi i diasporës në emër të Kosovës duhet të nxitet duke i përkrahur rrjetet e diasporës, iniciativat me bazë në komunitet dhe një varg përpjekjesh të diplomacisë publike.*

## Qëllimi

Qeveria e Kosovës ka iniciuar punën në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Kosova 2020. SKZH e Kosovës është një dokument kryesor për vizionin strategjik për zhvillimin e vendit deri në vitin 2020. Ai prioritetizon politikat me qëllim të arritjes së progresit të prekshëm në fushat të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe kohezionin social. Modeli i rritjes ekonomike dhe kohezionit social për Kosovën, i shtjelluar nga ky projekt ka dalë me një listë të prioriteteve potenciale të politikave të cilat janë drejtpërdrejt të lidhura me objektivin strategjik të arritjes së normave vjetore të rritjes prej 7-8% deri në vitin 2020 duke zhbllokuar potencialin ekonomik të punës dhe burimeve natyrore në mënyrë që të maksimizohet prodhimi dhe të zbutet varfëria. Lista e lartpërmendur e prioriteteve të politikave është bazuar në analizën mbi pengesat për zhvillim ekonomik të Kosovës dhe është harmonizuar me prioritetet nga reformat strukturore të identifikuar në kuadër të Programit të Reformave Ekonomike të Republikës së Kosovës.

## Arsyetimi

### Analiza e situatës

Diasporat mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e vendit të origjinës nëpërmjet kontributit të formave dhe trajtave të ndryshme. Duke dërguar **remitencat**, diasporat përmirësojnë stabilitetin makroekonomik dhe bilancin kombëtar të pagesave, të reduktojnë normat e varfërisë duke iu mundësuar familjeve të anëtarëve për të arritur nevojat themelore për konsumim dhe për të lehtësuar formimin e kapitalit njerëzor duke mundësuar shpenzime më të larta në arsim dhe shëndetësi.<sup>1</sup> Duke punuar dhe duke u arsimuar në vendet e tyre, diasporat akumulojnë **kapital që mund të investohet** për qëllime produktive në vendet e tyre të origjinës ose të fitojnë **aftësi të vlefshme që mund të transferohen**. Së fundi, po jo më pak me rëndësi, komunitetet aktive të diasporës mund të shërbejnë si urë vitale ndërmjet vendeve të tyre pritëse dhe vendeve të origjinës, **duke promovuar dhe lehtësuar lidhjet ekonomike dhe politike**. Nuk është e vështirë të nënvlerësohet roli që migrimi ka luajtur në të kaluarën dhe mund të luajë në zhvillimin e Kosovës në të ardhmen, thjeshtë për shkak të **madhësisë së diasporës dhe impulsit financiar** që i jep vendit, por gjithashtu edhe për shkak se **migrimi nga Kosova është një proces që ndodh ende**.

Diaspora e Kosovës është krijuar nëpërmjet disa valëve të migrimit që prej '60-ave dhe vlerësohet të jetë rreth 700000 sosh<sup>2</sup> – që do të thotë, 40% e popullsisë rezidente në Kosovë, një pjesë më e madhe se disa vende homologe në zhvillim me diaspora të konsiderueshme (p.sh. Gjeorgjia 25%, Maqedonia 22%, etj.). Afërsisht një e katërta e ekonomive familjare të shqiptarëve të Kosovës pranojnë remitencat nga këta emigrantë.<sup>3</sup> Në vitin 2012 remitencat morën afërsisht 17% të PKB në Kosovë, duke e bërë Kosovën “një nga 15 vendet që pranojnë më së shumti remitenca në gjithë botën, në raport me madhësinë e ekonomisë vendore”.<sup>4</sup> Shuma substanciale të parave futen në ekonomi çdo vit nëpërmjet turizmit të Diasporës (vlerësohet në 270 milionë euro në vitin 2012).<sup>5</sup> Varësia e madhe e ekonomisë mbi remitencat sugjerohet nga korrelacioni ndërmjet normave të rritjes së PKB-së në Kosovë dhe këtyre të vendeve ku qëndron diaspora e Kosovës (shih figurën 1).



Figura 1 - Rritja e PKB real në Kosovë dhe në vendet e qëndrimit të diasporës kosovare në %

.....

Paaftësia e ekonomisë kosovare për t'u rritur në norma të cilat e absorbojnë kohortën e madhe të personave të rinj që hyjnë në tregun e punës siguron që **migrimi do të vazhdojë të jetë një prej rrugëve kryesore për gjenerimin e të ardhurave** në të ardhmen, veçanërisht për punëtorët e pakualifikuar. Të dhënat e anketave sugjerojnë që rreth gjysma e individëve në mes moshave 18-36 planifikojnë të migrojnë në të ardhmen<sup>6</sup> përderisa vlerësohet se rreth 12000 – 13000 njerëz e lëshojnë Kosovën çdo vit, veçanërisht njerëzit e rinj, që i bie gjysma e numrit të atyre që hyjnë në tregun e punës.<sup>7</sup> Përreth 85% e tyre pretendojnë që kanë migruar për arsye ekonomike.

Ajo që e bën migrimin një aset potencial në agjendën zhvillimore të Kosovës është jo vetëm mundësia që ofron për gjenerimin e të ardhurave në afat të shkurtër, por veçanërisht fakti që diaspora e Kosovës **qëndron në disa nga vendet perëndimore më të industrializuara** ku ajo është në pozitë që të akumulojë kapital substancial, të fitojë aftësi të avancuara dhe të zhvillojë lidhje në mes Kosovës dhe tregjeve fitimprurëse. Pjesa më e madhe e emigrantëve kosovarë janë të vendosur në Gjermani (33%) dhe Zvicër (25%), të ndjekur nga Italia (8%), Sllovenia (6%), Austria (6%), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (4%) dhe të tjerët kryesisht në vendet skandinave dhe të Beneluxit.<sup>8</sup> Afërsisht 95% të udhëheqësve të ekonomive familjare të emigrantëve në këtë vende janë të punësuar dhe pak më shumë se gjysma e familjarëve (51%) thanë se ata kanë të ardhura mujore më të mëdha sesa 2000 euro në muaj – një figurë e cila sipas gjasave është e raportuar më pak sesa që është. Shumica e tyre (93%) thanë se ata i dërgojnë 30% të të ardhurave të tyre si remitenca.<sup>9</sup>

Pavarësisht dërgimit, në vazhdimësi, të niveleve shumë të larta të remitençave gjatë dekadave të kaluara, studimet sugjerojnë se shumë prej potencialeve financiare dhe njerëzore të diasporës mbeten të pashfrytëzuara dhe raporti në mes Kosovës dhe diasporës së saj momentalisht është në një **udhëkryq**. Ekziston një konsensus në rritje si brenda diasporës ashtu dhe politikëbërësve në Kosovë mbi nevojën për **një tranzicion** nga roli tradicional dhe spontan si një rrugë shpëtimi financiar dhe emergjent – një rol në të cilin diaspora gjithnjë e më shumë ndihet e frustruar dhe e madje e abuzuar – te një rol ku burimet e saj janë të shfrytëzuara më strategjikisht për qëllime të zhvillimit afatgjatë.

Potenciali i pashfrytëzuar ilustron nga **niveli përgjithësisht i ulët i investimeve** nga diaspora dhe pranuesit e remitençave, veçanërisht në kapital produktiv ose ndërmarrje private. Më pak se 36% pjesëtarëve të diasporës u deklaruan të kenë bërë ndonjë formë investimi në vendin e tyre të origjinës, përderisa pranuesit e remitençave deklarojnë se ata i përdorin vetëm 4% të parave për qëllime të tilla.<sup>10</sup> Në vitin 2012, investimet e diasporës u kufizuan kryesisht në ndërtimtari (47%) dhe blerje të pronës së patundshme (26%), nëpërmjet të cilës pjesëtarët e diasporës kryesisht kanë përmirësuar kushtet e banimit për vetveten dhe për familjet e tyre në Kosovë. Vetëm një pjesë e vogël e investimeve të diasporës shkuan në sektorë produktivë sikurse bujqësia (10%) ose industria përpunuese (6%).<sup>11</sup>

Sidoqoftë, të dhënat sugjerojnë që ekziston **një interes i konsiderueshëm ndërmjet pjesëtarëve të diasporës për të investuar shumë prej resurseve të tyre në Kosovë** nëse do të ekzistonin kushtet dhe mundësitë e nevojshme.<sup>12</sup> Kjo konfirmohet nga fakti që tanimë ka pasur disa raste të investimeve të suksesshme të diasporës në Kosovë, pavarësisht pengesave të perceptuara në mjedisin e biznesit ose mungesës së stimujve të veçantë.

3CIS, i themeluar nga një ndërmarrës nga diaspora e SHBA-ve, momentalisht është eksportuesi më i madh i shërbimeve, duke siguruar shërbime shumë të specializuara të përkrahjes së rrejtë të TI-së për disa nga kompanitë më të mëdha globale të telekomunikimit.<sup>13</sup> Stone Castle, prodhuesi më i madh në Kosovë i verës, që prodhon rreth 30 milionë litra verë për vit dhe eksporte në vendet sikurse Gjermania dhe SHBA, është një ndërmarrje ish-shtetërore e privatizuar nga një biznesmen i diasporës kosovare në SHBA.<sup>14</sup> Këto investime kryesisht mendohet se kanë ndodhur kryesisht sepse ndërmarrësit e diasporës që ishin pas tyre, për shkak të familjaritetit me vendin e tyre, qenë në gjendje të kuptojnë më mirë mundësitë dhe kishin vullnet për të tejkaluar ato lloj barrierash që do t'i frikësonin dhe largonin investuesit e tjerë të huaj.<sup>15</sup>

.....

Diaspora shihet si “një burim i vlefshëm investimi, veçanërisht – por jo e kufizuar – në aktivitetet ekonomike ku emigrantët janë të punësuar në vendet e tyre të qëndrimit, sikurse ndërtimtaria, hotelet dhe restorantet dhe industria prodhuese.”<sup>16</sup> Krahasimet statistikore sugjerojnë që interesi për të investuar është më i lartë ndërmjet atyre që kanë familje më të mëdha në Kosovë, vijnë nga zonat rurale, që aktualisht kanë remitencë më të mëdha sesa shumat mesatare dhe kanë qëndruar më gjatë në vendet e tyre të qëndrimit (d.m.th. kanë pasur mundësinë e akumulimit të kapitalit).<sup>17</sup>

Megjithatë, pengesa kryesore për të investuar është **reziku financiar i lartë** i perceptuar për shkak të disa shqetësimeve të njëjta nga të gjithë investuesit e të tjerë të huaj dhe vendorë: d.m.th. sundimi i ligjit, korrupsioni, administrata joefikase, etj. Madje edhe kompania kryesore e diasporës, 3CIS, u ankua këtë vit se i është nënshtruar trajtimit jo të drejtë nga Administrata Tatimore e Kosovës, në formë të taksës prej 500 mijë eurosh që ajo beson se nuk ishte e detyruar ligjërisht të paguante.<sup>18</sup>

Një barrë tjetër specifike për investimet e diasporës është **mungesa e informacionit për tregun dhe shërbimet e dobëta të lehtësimit të investimeve**. Bizneset e diasporës ankohen për mungesën e një qasjeje të shpejtë për këto shërbime që do të ishte më afër me vendet e qëndrimit dhe që përgjegjësia aktuale ndaj kërkesave për informim ose lehtësim të shërbimeve nuk është sistematike, kryesisht për shkak të mandateve që bien ndesh dhe/ose kapaciteteve të kufizuara të institucioneve të ndryshme sikurse Ministria e Diasporës (MeD), ambasadave dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Ambasadat nuk janë në pozitë për të ofruar përkrahje domethënëse meqenëse qeveria e Kosovës deri më tani ka pasur vetëm një zyrtar për ndërlidhje ekonomike të vendosur në Bruksel, përderisa largësia dhe kapacitetet janë po ashtu një pengesë për qasje në shërbimet e përkrahjes së MeD-së dhe KIESA-s.

Një problem tjetër është “perceptimi i disa pjesëtarëve të diasporës se nuk janë të vlerësuar nga institucionet kosovare”.<sup>19</sup> Në shumë prej vendeve në zhvillim, “shpesh, diasporat ndihen se qeveritë e vendeve të origjinës i **shohin ato thjeshtë si lopë të keshit**.”<sup>20</sup> Një ndjenjë e ngjashme duket se është zhvilluar në Kosovë meqenëse pjesëtarët e diasporës shpesh deklarojnë se ata kanë bërë mjaft shumë dhe ndihen të irrituar me rastet e trajtimit jo me respekt nga institucionet publike, veçanërisht me perceptimin e niveleve të larta të korrupsionit të cilat ata i shohin si shumë frustues në kohën kur janë duke dërguar shuma të mëdha të të ardhurave të tyre të fituara me vështirësi në formë të remitencave.


Bizneset e diasporës po ashtu shprehin frustrimin e tyre me atë që e konsiderojnë si një praktikë dhjetëvjeçare të politikëbërësve të dhënies së premtimeve të zbehta për përkrahje që kurrë nuk janë ndjekur në praktikë.<sup>21</sup> Prandaj, ekziston një **mungesë e madhe e besimit në seriozitetin e institucioneve të Kosovës në angazhimin e saj me diasporën dhe në agjendën zhvillimore në përgjithësi**. Besimi vlerësohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Instituti për Politika të Migrimit (MPI) si një prej komponentëve kryesorë për një strategji të angazhimit të diasporës së vendit.<sup>22</sup>

Mungesa e të dhënave të detajuara mbi diasporën e bën të vështirë për të pasur një pasqyrë të qartë se si migrimi e afekton diasporën në kuptimin e **marrjes së arsimit dhe kualifikimeve në vendet e destinacionit**. Të dhënat e studimeve sugjerojnë se ka më shumë dallim në kuptimin e viteve mesatare të arsimit të marrë ndërmjet pjesëtarëve të diasporës dhe banorëve në Kosovë (përkatesisht 11.5 and 11.4).<sup>23</sup> Megjithatë, ky tregues fsheh faktin që emigrantët qëndrojnë në vende me një cilësi më të lartë të arsimit dhe që ata mund të ngrisin kualifikimet e tyre në vendin e punës për shkak të perspektivës më të lartë të punësimit sesa joemigrantët. Për më tepër, studimet sugjerojnë se “një pjesë e madhe e emigrantëve kanë arritur një nivel të lartë të arsimit që e kanë pasur në kohën e largimit”<sup>24</sup>, e cila duket se tregon që mobiliteti ka çuar në drejtim të rritjes së formimit të kapitalit njerëzor.

Ekzistojnë gjithashtu disa shenja se ka **transferime të aftësive** që ndodhi nëpërmjet emigrantëve që kthehen në Kosovë. Një numër i konsiderueshëm i emigrantëve janë kthyer dhe kanë gjetur punë, me




numrat e të kthyerve që përbëjnë rreth gjysmën e atyre që lënë vendin në baza vjetore (rreth 6 mijë të kthyer në vitin 2009 dhe 9 mijë në vitin 2010).<sup>25</sup> Një pjesë e madhe janë të kthyerit me forcë, por ekzistojnë po ashtu shumë të kthyer vullnetarë, veçanërisht punëtorët me kualifikime të larta për të cilët tregu i punës duket se ka kërkesë të konsiderueshme. Kjo dëshmohet nga të dhënat që sugjerojnë se pjesa e tregut të punës që kërkon kualifikime të larta preferon të kthyerit në raport me joemigrantët: të parët kanë një shans më të madh për të gjetur punë në Kosovë sesa të fundit (shih më poshtë figurën 2).



**Figura 2 - Statusi i punësimit i të kthyerve kundrejt statusit të punësimit të joemigrantëve**  
Burimi: Anketë e migrimit 2009 (Banka Botërore, 2011)

Megjithëse kthimet spontane kanë ndodhur madje edhe pa ndonjë politikë qeveritare, ende duket se ekziston një potencial i pashfrytëzuar për sa i përket **emigrantëve të kualifikuar të cilët kanë interes për t'u kthyer, ose së paku për t'u angazhuar në projekte ose aktivitete të përkohshme që do t'u mundësonin atyre të punojnë brenda dhe jashtë vendit ose të hulumtojnë mundësitë afatgjata.** Një anketë e vitit 2009 gjeti se plot 55% e emigrantëve të kualifikuar kanë plane për kthim eventual, më shumë sesa emigrantë e pakualifikuar (31%).<sup>26</sup> Ky është një fakt i rëndësishëm për t'u konsideruar në kohën kur ekziston një dëshmi bindëse se shumica e bizneseve kosovare që përpiqen të zgjerohen janë duke u ballafaquar me "një nevojë të paarritshme për fuqi punëtore më të kualifikuar dhe më të aftësuar"<sup>27</sup> dhe sektori i arsimit është duke dështuar për të prodhuar sipas nevojave të tregut.

Anketat me sektorët industrialë, për shembull, kanë zbuluar se gjetja e punëtorëve të kualifikuar është një problem serioz për shumë firma që përpunojnë metalin (30%), tekstilin (40%) dhe firmat që përpunojnë drurin (46%) dhe është më i madh, sa më e madhe të jetë firma.<sup>28</sup> Industria në rritje dhe në ekspansion e shërbimeve të TI-së (p.sh. kompanitë tipike të shërbimeve të transferuara sikurse 3CIS) është po ashtu duke u ballafaquar me sfida në gjetjen e punëtorëve të kualifikuar meqenëse e ka shterur rezervën ekzistuese të punëtorëve të kualifikuar.<sup>29</sup> Megjithatë, sikurse me informatat mbi mundësitë e investimit, ekziston një shpërndarje e varfër e informatave për diasporën për mundësitë për punë, sikurse dhe mungesë stimujsh që mund ta lehtësojnë angazhimin e tyre.



**Figura 3 - Gjetja e punëtorëve të kualifikuar është një vështirësi serioze (% e firmave, sipas sektorit të prodhimit)**

Dëshira e shprehur për kthim në Kosovë mund të jetë impulsive dhe e tepruar kur shprehet në përgjigjet

.....

në anketa, por megjithatë ajo tregon se diaspora kosovare ka **lidhje të fuqishme me atdheun dhe/apo dëshirë për të kontribuar**, e cila e bënë atë potencialisht një aleat të madh në agjendën zhvillimore të Kosovës. Më shumë se gjysma e pjesëtarëve të diasporës (57%) e vizitojnë vendin së paku njëherë në vit, përderisa 36% e vizitojnë më shumë se njëherë.<sup>30</sup> Në një anketë të kryer në vendkalimet kufitare në vitin 2007, pothuaj gjysma e pjesëtarëve të diasporës thanë se ata janë anëtarë të shoqatave të diasporës në vendet e tyre të qëndrimit.<sup>31</sup> Këto të fundit kanë luajtur një rol jetik para vitit 1999 në Kosovë, duke u angazhuar në mobilizimin e burimeve dhe në përkrahje politike në vendet e tyre.

Megjithatë, rrjetet e diasporës momentalisht janë të paafta për të luajtur rolin që ato e kanë luajtur më herët për shkak se ato janë **shumë të fragmentuara përgjatë vijave politike dhe ideologjike**. Ato kanë vuajtur nga një problem i madh i veprimit kolektiv që prej vitit 1999, kur shkalla e lartë e homogjenizimit për shkak të luftës kundër Serbisë mori fund. Siç e tha një aktivist i diasporës: “Diaspora e ka humbur kauzën e saj me largimin e armikut të përbashkët.”<sup>32</sup> Për më tepër, asaj “i mungojnë kapacitetet dhe organizimi i duhur që të bëjë presion mbi institucionet relevante në Kosovë për t’u marrë me shqetësimet e lidhura me diasporën.”<sup>33</sup>

Ekzistojnë, megjithatë, një numër **iniciativash me bazë në komunitet** dhe spontane që janë treguar efektive në angazhimin e diasporës në çështje të ngushta tematike. ECIKS, me qendër në Vjenë është një shembull i organizatës që promovon investimet me bazë në diasporë.<sup>34</sup> Inkurajimi i Ndërmarrësve të Rinj (EYE) është po ashtu një iniciativë private e krijuar nga biznesmenë të suksesshëm të diasporës të cilët janë kthyer në Kosovë.<sup>35</sup> KosovoDiaspora.org është një iniciativë e bazuar në turma që synon të angazhojë diasporën dhe promovojë arritjet e diasporës te audiencat e jashtme.<sup>36</sup> Kuvendi i shqiptarëve në Zvicër, i themeluar së fundmi, po ashtu ka qenë i suksesshëm në organizimin e një numri projektesh, veçanërisht iniciativave kundër fyerjes.<sup>37</sup> Ekzistojnë po ashtu disa raste shembullore të pjesëtarëve të diasporës me prejardhje nga fshatra të veçanta (p.sh. “Pogragja”) që organizohen për të investuar në projekte të infrastrukturës publike lokale dhe madje paguajnë paga të rregullta për stafin mirëmbajtës.<sup>38</sup>

Angazhimet e diasporës të çfarëdo forme janë përfundimisht të varura nga efektiviteti i **institucioneve të atdheut në lehtësimin e këtij angazhimi**, por gjithashtu edhe në sigurimin e shërbimeve të përkrahjes në vendet e qëndrimit (shërbimet konsullore, aktivitetet kulturore, etj.) që ndihmojnë diasporën edhe të integrohet edhe të ndihet e vlerësuar nga vendi i tyre i origjinës. Një raport i Institutit të Bankës Botërore konfirmon këtë kur thotë se “sado të mëdha dhe ndërmarrëse të jenë rrjetet e profesionistëve të diasporës, institucionet e vendit që janë të interesuara dhe të afta për të zbatuar projekte të përbashkëta me emigrantët janë vendimtare.”<sup>39</sup>

Ligji për Diasporën dhe Migrimin e ka mandatuar MeD-në që të shërbejë si një institucion qendror që koordinon përpjekjet për politikat e diasporës, sikurse dhe për të siguruar një varg të gjerë shërbimesh të përkrahjes sikurse udhëheqja e qendrave kulturore në vendet e qëndrimit, financimi i projekteve të vogla, përkrahja e përpjekjeve për arsim gjuhësor plotësues dhe lehtësimi i rrjetëzimit të biznesit. Në nivel lokal, 29 komuna në Kosovë kanë themeluar zyra të ndërlidhjes me diasporën. Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) po ashtu ofron përkrahje për diasporën nëpërmjet ambasadave të saj dhe shërbimeve konsullore dhe ka krijuar një portofol të diplomacisë publike, në të cilin, herë pas here ka shfrytëzuar rrjetet ekzistuese të diasporës dhe individëve për të ndjekur objektivat e politikës së jashtme të Kosovës.<sup>40</sup>

Megjithatë, efektiviteti i kornizës institucionale që synon të përkrah diasporën momentalisht pengohet nga një varg i gjerë problemesh. Së pari dhe që është me më rëndësi është çështja e **kapaciteteve financiare dhe teknike** meqenëse institucionet e diasporës mendohet se kanë “staf të pamjaftueshëm dhe të pakualifikuar” dhe “alokim të pamjaftueshëm të buxhetit”.<sup>41</sup> Mundësitë për grante për iniciativat e diasporës nëpërmjet MeD-së ekzistojnë por janë të kufizuara në shtrirje dhe madhësi.

.....

Përderisa ekziston një vlerësim në diasporë për disa nga shërbimet e përkrahjes nëpërmjet shërbimeve konsullore dhe ambasadave, rolet që bien ndesh ndërmjet institucioneve mandatet e paqarta bëjnë që të mos ketë **një adresë qendrore për ndarjen e informatave mbi mundësitë dhe lehtësimin e shërbimeve** (p.sh. punët, investimet, grantet, etj.). **Njohuria institucionale mbi diasporën** është po ashtu e kufizuar, veçanërisht sa i përket aftësive dhe ekspertizës, megjithëse është duke ndodhur një proces i regjistrimit të rezidentëve, bizneseve dhe shoqatave të diasporës.

Ndoshta çka është me më rëndësi, MeD-ja shihet kryesisht si e **pafuqizuar mjaftueshëm** brenda spektrit të institucioneve qeveritare për të përkrahur interesat në emër të diasporës dhe të jetë e përgjegjshme ndaj nevojave, sidomos, sikur në rastin e qeverisë së mëparshme, kur ministria i takonte një partneri junior të koalicionit. Përveç kësaj, nuk ekzistojnë mekanizma për të siguruar **përfshirjen e diasporës në vendimarrje**, meqenëse vetë diaspora nuk ka zë brenda qeverisë (një pjesë e vogël e votave nëpërmjet postës). Kjo e redukton pronësinë dhe besimin në procesin e angazhimit. Qasja e centralizuar ndaj politikave për diasporën shpesh është treguar problematike, meqenëse "politikat që shtyhen shumë fuqishëm nga qeveria mund të veprojnë si parandalues për angazhimin e diasporës."<sup>42</sup>

### Politikat aktuale

Zhvillimi i politikave për diasporën është ende në një fazë embrionike dhe eksperimentale, me disa plane që tashmë janë zhvilluar, por me sfida të qarta në zbatim që janë shumë të dukshme. Nga një perspektivë strategjike, [Strategjia për Diasporën](#) (2014-2017) është dokumenti kryesor udhërrëfyes për politikat e MeD-së. Ajo parasheh **një qëllim të përzier të përkrahjes së integrimit të diasporës në vendet e qëndrimit përderisa duke e ruajtur identitetin e tyre kulturor dhe duke i lehtësuar investimet dhe transferimin e aftësive**. Për këtë qëllim dokumenti nënvizon katër objektiva të themelore të politikave që thuhet se do të arrihen nëpërmjet një varg aktivitetesh:

- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës
- Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën
- Përkrahja e integrimit të pjesëtarëve të diasporës në vendet e tyre të qëndrimit
- Lehtësimi i përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik

Aktualisht nuk ekzistojnë **stimuj të veçantë për investimet e diasporës**. Diaspora mund të llogaris vetëm në të drejtat dhe privilegjet e përgjithshme të siguruara nga Ligji për Investimet e Jashtme. Sidoqoftë, Strategjia për Diasporën përfshin një kapitull të veçantë për stimujt dhe shërbimet e përkrahjes të planifikuara. Kjo përfshin masa sikurse: 1) organizimi i panairëve të rregullta të biznesit për diasporën, konferencave dhe forumeve (evenimenteve b2b); 2) marrëveshjeve me vendet e qëndrimit të diasporës mbi çështjet e tilla si: a) shmangies së tatimit të dyfishtë; b) mbrojtjes së investimeve dhe; c) lëshimit të garancive për investim nga qeveria e Kosovës; 3) sigurimin e pushimeve nga taksat dhe stimujve të tjerë financiarë mbi importin e lëndëve të para dhe pagesave të tjera të ndërlidhura qeveritare, etj. Sidoqoftë, asnjë nga këto masa nuk janë shtjelluar në detaje se si do të zbatohen, veçanërisht duke marrë parasysh pengesat e identifikuar në kapacitet dhe fuqinë e pamjaftueshme të MeD-së për të zbatuar ndryshimet që prekin institucionet e tjera (p.sh. Ministria e Financave).

Ekzistojnë hulumtime substanciale të bëra së voni në Kosovë **mbi mjetet që mund të përdoren për të stimuluar investimet kolektive të diasporës**, përfshirë këtu studimet e fizibilitetit për një [Fond Ndërkombëtar të Garancive \(IGF\)](#), [Fondi i Investimeve Private](#), [Produktet Bankare të Diasporës](#), [Zonat Ekonomike](#) dhe [Obligacionet Komunale](#). Përderisa disa prej këtyre mekanizmave janë në sferën e sektorit privat, ka pasur disa reflektime rreth **instrumentit të garancisë dhe skemës së obligacioneve** për të cilat do të ishte përgjegjëse qeveria. Do të thotë, rekomandimi nga studimi i fizibilitetit nuk thotë të krijohet një instrument i garancisë për diasporën, por për të pasur stimuj të veçantë për diasporën nëpërmjet Instrumentit të Kosovës për Përkrahjen e Kredive, një kompani publiko-private e themeluar së fundmi për NVM-të që pritet të jetë operacionale në vitin 2015.<sup>43</sup> Skema e obligacioneve komunale

.....

u menduar të jetë e parealizueshme kryesisht për shkak të kapaciteteve të dobëta në nivel komunal.

Ekzistojnë disa shërbime të përkrahjes ose stimuj të investimeve në Kosovë që ofrohen nëpërmjet institucionet lokale ose projektet e financuara nga donatorët. Për shembull, projekti i financuar nga austriakët KOSME i vendosur brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) është aktualisht duke zbatuar një **Skemë të Këshillimit me Kuponë (SKK)** duke siguruar investuesit potencialë, përfshirë ata nga Diaspora, me subvencione për konsulentët që të bëjnë hulumtime të tregut dhe shërbime të tjera të biznesit. Një **skemë e granteve NMVM** prej 4 milionë eurosh u nis në vitin 2014 me BE-në dhe financimi i MTI-së u bë nëpërmjet IOM-it. Skema financon deri në 85% (maks. 25 mijë euro) investimet për firmat mikro dhe deri në 75% (maks. 200 mijë euro) investimet për ato të vogla dhe të mesme në një varg sektorësh produktivë dhe pranoi 784 aplikacione (70% e të cilëve kaloi fazën e parë të vlerësimit).<sup>44</sup> Megjithatë, skema ka si cak bizneset kosovare si tërësi dhe jo në mënyrë specifike diasporën, dhe një prej kriterëve të pranueshmërisë është që firmat përfituese duhet të regjistrohen së paku për dy vite.<sup>45</sup>

Po ashtu, u zbatua një skemë pilote e granteve korrespondente në komunën e Gjilanit nëpërmjet një projekti të DEED dhe Agjencisë për Zhvillim Rajonal (AZHR) Lindje. Janë dhënë tetë grante me vlerë prej 3000 eurosh për bizneset që do të investonin të njëjtën shumë duke shfrytëzuar fondet nga familjet e tyre jashtë vendit.<sup>46</sup>

Sa i përket lehtësimit të **transferimit të aftësive**, ekziston vetëm një program qeveritar që siguron stimuj për **akademikët** – Programi për Kthimin e Trurit që zbatohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Sidoqoftë, në katër vitet e funksionimit të tij ai mund të konsiderohet si një dështim meqenëse ka dështuar të tërheq ndonjë aplikacion të kualifikuar.<sup>47</sup> Në sferën e **administratës publike**, ekziston brenda Zyrës së Kryeministrit (“Fondi për Kuadro”), që ofron shtesa në paga për stafin me kualifikime të larta brenda Shërbimit Civil të Kosovës, nga i cili mund të përfitojnë edhe pjesëtarët e diasporës, megjithëse grupi kryesor përfitues është popullsia e Kosovës si tërësi. Sa i përket planeve për të ardhmen, Strategjia për Diasporën thjesht deklaroi që do të përkrahen së paku njëzetë projekte të praktikës profesionale nga studentët e diasporës të cilët do të vendosen në institucionet publike të Kosovës.

Sa i përket transferimit të aftësive në **sektorin privat**, nuk është bërë aq shumë. Një prej komponentëve kryesorë të Strategjisë për Diasporën është zhvillimi i Regjistrimit të Diasporës i cili po ashtu përfshin informimin për kualifikimet profesionale. Sidoqoftë, është e paqartë se si të dhënat nga regjistri do të shfrytëzohen dhe se cilat lloje mekanizmesh do të përdoren për të tërhequr punëtorët e kualifikuar në sektorin privat.

Nuk ekzistojnë plane për adresuar çështjen e kapaciteteve ose problemeve brenda kornizës së institucioneve që i shërbejnë diasporës, që është vlerësuar të jetë vendimtare për **ndërtimin e besimit në institucionet e Kosovës dhe për të siguruar pronësinë e diasporës mbi politikat**. Korniza institucionale dhe çështjet se si është përcaktuar portofoli i diasporës janë kryesisht të varura mbi proceset politike të nivelit të lartë, sikurse marrëveshjet e koalicionit, në të cilat vlerësimet politike luajnë rol më të madh sesa ato të politikave strategjike. Strategjia e Diasporës po ashtu parasheh një **zë në rritje për diasporën** në çështjet e brendshme të Kosovës duke krijuar mundësitë për të votuar nga jashtë vendit. Por diskutimet me akterët tregojnë se kjo mund të has në rezistencë politike meqenëse preferencat politike të diasporës për votim shihen si më të favorshme për disa parti sesa për të tjerat.<sup>48</sup>

Çështja e institucioneve të fragmentuara me bazë në diasporë, sidoqoftë, është duke u adresuar nga procesi aktual i krijimit të institucioneve sikurse Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës, i cili do të shërbente si mekanizëm qendror që përfaqëson interesat e diasporës, si dhe rrjetet e biznesit të diasporës (kombëtare dhe globale) që do të lehtësonin lidhjet ndërmjet bizneseve të diasporës dhe do t'i lidhnin ato me institucionet dhe firmat kosovare. Deri më tani, janë krijuar katërmbëdhjetë rrjete kombëtare të

.....

biznesit të diasporës në vendet e qëndrimit, duke përfshirë një union global të rrjeteve të diasporës, i cili ka një kryetar dhe dy nënkryetarë, një për SHBA dhe një për Evropë. Krijimi i Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës nuk ka lëvizur para. Sidoqoftë, është e paqartë se si këto institucione do ta përmbushin mandatin e tyre përtej ekzistencës së tyre formale në letër (p.sh. nuk ekzistojnë informata mbi planet vjetore të punës, llojet e aktiviteteve, modalitetet e financimit, etj.). Strategjia e Diasporës përmend shkurt që Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës pritet të ketë një sekretariat në Kosovë për të udhëhequr aktivitetet.

Aktualisht ekzistojnë disa masa për të **stimuluar dhe shpërblyer** pjesëtarët e diasporës të cilët kontribuojnë në imazhin e Kosovës jashtë vendit dhe për të ndërtuar lidhje me vendet e huaja si ambasadorë joformalë. MeD kohë pas kohe lëshon mirënjohje për pjesëtarët më të shquar të diasporës dhe ambasada e Kosovës në Zvicër lëshon një shpërblim vjetor për pjesëtarët më aktivë të diasporës. Zyra e Presidentit të Kosovës deri më tani ka lëshuar vetëm një medalje të “Ambasadorit të nderit” për yllin e popit, Rita Ora. Sidoqoftë, këto masa janë më shumë sporadike dhe nuk ekziston diçka përtej shpërblimeve formale që mund të përkrahin pjesëtarët e diasporës për t’u angazhuar në diplomacinë publike.

Këto mangësi janë tejkaluara nga iniciativat me bazë në komunitet sikurse KosovoDiaspora.org – një platformë me shtrirje në komunitet e cila afirmon aktivitetet e diasporës së Kosovës – ose iniciativa WikiAcademy nga Fondacioni IPKO – të cilat iu mundësojnë kosovarëve në përgjithësi (jo vetëm diasporës) për t’u angazhuar në emër të Kosovës duke prodhuar përmbajtje mbi Kosovën nëpërmjet internetit. MeD-ja po ashtu ka nisur procesin e krijimit të rrjeteve të rinisë dhe studentëve të diasporës, që, ndërmjet të tjerash, mund të shfrytëzohen për të angazhuar ambasadorët e rinj në universitete dhe/apo modalitete të tjera.

### **Definicioni i problemit**

Diaspora e madhe kosovare ka lidhje të fuqishme me atdheun e saj dhe është në gjendje për të kontribuar në mënyrë përmbajtësore në zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të Kosovës duke investuar kapitalin e saj financiar të akumuluar, duke transferuar aftësitë dhe duke lehtësuar lidhjet në mes Kosovës dhe tregjeve të pasura perëndimore. Sidoqoftë, **mobilizimi i diasporës kosovare në përkrahje të zhvillimit të Kosovës aktualisht nuk është duke arritur potencialin e saj domethënës, kryesisht për shkak të rrezikut financiar ndaj investimeve; rrjedhjes së dobët të informacionit dhe shërbimeve të dobëta të lehtësimit; një problem të veprimit kolektiv që rezulton nga fragmentimi politik dhe një mungesë besimi në institucionet e Kosovës; si dhe një rregullimi institucional joefektiv për zhvillimin e politikave dhe ofrimin e shërbimeve për diasporën.** Struktura e problemit paraqitet në mënyrë grafike në pemën e problemit (figura 4).

Mobilizimi i ulët i diasporës jo vetëm që rezulton me më pak investime të drejtpërdrejta të diasporës në Kosovë, por gjithashtu – nëpërmjet më pak angazhimi në diplomacinë publike dhe rrjetëzimit – rezulton edhe në imazh më të keq të Kosovës jashtë vendit dhe shanse të humbura për eksporte, të cilat të gjitha rezultojnë me norma më të ulëta të rritjes ekonomike. Paaftësia për të pasur më shumë kontribut nga punëtorët me kualifikime të larta nënkupton më pak transferim të aftësive dhe më pak krijim të kapitalit njerëzor, që nga ana tjetër ndikon rritjen ekonomike.




Figura 4 - Pema e problemit të mobilizimit të diasporës

## Zgjidhjet potenciale të bazuara në praktikat më të mira

### Shfrytëzimi i granteve korresponente: Meksika dhe Moldavia

Grantet korresponente për investimet e diasporës janë popullore në gjithë botën, megjithëse nuk janë kryer edhe aq shumë vlerësime pas përfundimit të punëve. Ato janë një prej mjeteve që mund të adresojnë një prej barrierave kryesore ndaj investimeve të diasporës, do të thotë çështjen e **rrezikut financiar** në një mjedis të pafavorshëm biznesi. Një grant korresponent është një transferim i papërsëritshëm, i parimbursueshëm për përfituesit e projektit. Ai bazohet në një arsyetim specifik të projektit për një qëllim të caktuar dhe me kushtin që përfituesi jep një kontribut të përcaktuar për qëllimin e njëjtit të projektit. Meqenëse transferimet e papërsëritshme dallojnë nga transferimet e përhershme publike, sikurse subvencionet për mjetet ose shërbimet, prandaj ato nuk janë zgjidhje e

.....

qëndrueshme për financimin e ndërmarrjeve.

Megjithatë, skemat e granteve korrespondente, të hartuara mirë mund të ndihmojnë qoftë investimet dhe investuesit privatë të rriten ose tregjet me rezerva më të vogla duke tejkalluar pengesat specifike për hyrjen në treg për grupe të caktuara, teknologji ose ofrues të shërbimeve. Për këtë qëllim grantet duhet të kenë vetëdije të mjaftueshme për tregun – që nënkupton se ata duhet të kenë caqe të përcaktuara, me përzgjedhje të qartë dhe kritere të pranueshmërisë, me kohëzgjatje të përcaktuar, të vulosura dhe transparente dhe ata duhet të përforcojnë më tepër sesa të dobësojnë kanalet ekzistuese të ofrimit të shërbimeve.

Atraktiviteti i skemës së granteve korrespondente për investimet e diasporës varet nga zotimi financiar i qeverisë për të përkrahur krijimin e bizneseve dhe/apo zbatimin e projekteve. Vendet e Afrikës subsahariane kanë zbatuar një projekt të suksesshëm të tregut të diasporës afrikane, të përkrahur nga USAID-i dhe Western Union-i, që ka ofruar grante korrespondente, me raport minimal të kthimit të vlerës prej një me një për krijimin e bizneseve të reja. Skema e granteve korrespondente më popullore për tërheqjen e remitencave dhe kursimeve të emigrantëve në investime ka nisur në Meksikë. Megjithëse në përgjithësi të suksesshme, skemat e granteve korrespondente kanë disa kufizime që janë marrë parasysh nga vendet e tjera që po ashtu kanë zhvilluar programe të ngjashme. Një program më i thjeshtë dhe më i menaxhueshëm, i bazuar në përvojën e Meksikës është përhapur kohëve të fundit në Moldavi. Këto dy raste janë paraqitur më poshtë shkurtimisht.

### **Meksika: program i granteve 3+1**

#### *Një përmbledhje e programit*

Në Meksikë, skema e granteve korrespondente që kanalizonte remitencat dhe kursimet në investime së pari u paraqit në vitin 1993 si një program 2 + 1 i kufizuar për projektet në shtetin Zacatecas. Në vitin 2001, me ndryshimet buxhetore që liruuan më shumë para për qeveritë komunale, ai u bë 3+1 dhe që atëherë ka financuar një numër projektesh përgjatë Meksikës.

Programi që mjaft i thjeshtë: për çdo dollar të pranuar nga një asociacion i caktuar i emigrantëve në SHBA për një projekt specifik, secili prej tre niveleve të qeverisë (komunal, shtetëror dhe federal) do të jepte me vlerë të njëjtë, duke shfrytëzuar paratë e pranuar nëpërmjet faturave të tatimeve dhe të ardhurave nga nafta nga Pemex, kompania shtetërore meksikane e naftës. Nëse, për shembull, organizata amerikane që përfaqëson emigrantët nga shteti meksikan i Zacatecas mbledh 45000 dollarë për një kishë të re në qytetin e Fresnillo-s, qeveritë komunale, shtetërore dhe federale të Meksikës do të jepnin nga 45000 dollarë secila, ashtu që projekti do të kishte përkrahje prej 180000 dollarësh.

Projekti u udhëhoq bashkërisht nga qeveria dhe asociacionet e vendlindjes të krijuara nga meksikanët që jetojnë në SHBA në mënyrë që të dërgojnë remitenca te vendlindjet e tyre specifike. Deri në vitin 2010, u financuan afërsisht 2500 projekte, me qeverinë federale që e vetme autorizoi për të shpenzuar afro 50 milionë dollarë. Këto para u shfrytëzuan për të financuar projektet për zhvillimin e komunitetit, sikurse për ofrimin e energjisë elektrike, infrastrukturës së banimit dhe projektet arsimore.

Pavarësisht suksesit të tij, pati një numër ankesash për impaktin praktik të planit. Disa përfshijnë pasojat e pashmangshme për të harmonizuar interesat e një numri kaq të ndryshëm njerëzish dhe qeverish të shtrirë larg si në kuptim gjeografik ashtu dhe hierarkik-imigrantët në Chicago dëshirojnë renovimin e një sheshi publik, përderisa zyra e kryetarit të qytetit në vendlindje është më e interesuar në një ujësjellës të ri. Të tjerët tregojnë buxhetet e kufizuara qeveritare si kufizim për impaktin e 3+1.

.....

## **Moldavia: PARE 1+1 programi i granteve korrespondente**

### Përmbledhje e programit

Duke u bazuar në përvojën e Meksikës, Moldavia ka nisur një program pilot të përshtatur të granteve korrespondente. Programi pilot PARE 1 +1 u nis në vitin 2010 për 2 vite dhe është shtyrë deri në vitin 2015 pasi u dëshmuua si i suksesshëm.

Qëllimi i programit është që të mobilizojë burimet njerëzore dhe financiare të emigrantëve dhe të familjarëve të tyre të nivelit të parë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Moldavi. Programi vepron sipas parimit 1+1, d.m.th. 1 leu i investuar nga një emigrant shoqërohet nga një leu i dhënë si grant, i investuar nga shteti. Shuma maksimale për grantin korrespondent nga ana e shtetit është afërsisht 12000 euro. Përveç granteve, programi po ashtu ofron informata, konsultim dhe trajnime ndërmarrëse për përfituesit dhe njerëzit e tjerë të interesuar.

Institucioni zbatues është Organizata për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (nën Ministrinë e Ekonomisë), në bashkëpunim me partnerët e ndryshëm zhvillimorë. Ajo menaxhon një fond të NVM-ve, nëpërmjet të cilit programi financohet si nga paratë publike, ashtu dhe nga fondet e donatorëve të destinuara për këtë qëllim. Që prej vitit 2010, programi PARE 1+1 ka tërhequr 10.2 milionë euro investime në sektorin e NVM-ve dhe ka ofruar grante në vlerë prej 5.5 milionë euro. Deri më tani janë përfunduar 313 kontrata. Bujqësia është sektori ku janë kanalizuar shumica e parave të programit (42% të të gjitha ndërmarrjeve bujqësore që kanë marrë pjesë në program). Programi ka qenë më i suksesshëm sesa që është pritur, meqenëse 1 leu si grant ka tërhequr 2.7 leu investime nga emigrantët. Si rezultat, 1 leu si grant ka gjeneruar rritje të PKB prej 1.72 leu.

Ka pasur më shumë aplikacione dhe kandidatë të përshtatshëm sesa burime publike të disponueshme për të qenë korrespondente me remitencat dhe kursimet e emigrantëve. Përveç kësaj, emigrantët pretendonin se tavanin që shumë i ulët dhe prandaj ata duhej të ulnin ambiciet e tyre sa i përket madhësisë dhe llojit të biznesit. Si përgjigje ndaj kësaj, qeveria është duke konsideruar të rris fondin për zbatimin e skemës së granteve, të marrë parasysh asociacionet e emigrantëve dhe të dyfishojë tavanin.

### **Ngritja e institucioneve efektive të diasporës: çka funksionon?**

Shumë prej institucioneve specifike për diasporën në vendin e origjinës janë kryesisht të kohëve të fundit dhe kanë evoluar nëpërmjet testimit dhe gabimit. Megjithatë këto përvoja kanë arritur të krijojnë një sens se çka është më thelbësore në sistemin institucional, pavarësisht faktit që ka dallime kontekstuale në mes vendeve që nuk mundësojnë zgjidhje të njëllota për të gjithë. Çështjet që dalin në shesh janë vendimtare për arkitekturën institucionale për ofrimin e shërbimeve janë fuqizimi i institucionit kryesor të diasporës, përfshirja e diasporës në vendimmarrje, zgjerimi i shërbimeve të përkrahjes në vendet e qëndrimit të diasporës me pika të qarta të kontaktit (one-stop-shop), dhe marrja e një qasjeje poshtë-lartë ku institucionet do të ishin përgjegjëse për të nxitur iniciativat me bazë në komunitet.

### **Fuqizimi i institucionit kryesor të diasporës**

Çështja e parë e rëndësishme është të sigurohet që institucioni i lidhur me diasporën të jetë në pozitë që të ketë zë mbi politikat dhe të angazhojë në mënyrë efektive të gjithë hierarkinë qeveritare, përdorëse të reduktojnë problemin e koordinimit në zbatimin e shërbimeve duke siguruar efektivitetin e kostos. Njëzetegjashëm vende kanë përcaktuar portofolin e diasporës te një ministri e veçantë dhe përvoja dëshmon që kjo zakonisht siguron alokim më të madh të buxhetit, por mund të dalin më shumë implikime në ofrimin e shërbimeve për shkak të niveleve institucionale dhe problemeve të koordinimit. Në vendet e tjera portofoli i është caktuar një ministria hibride zakonisht e bashkuar me



.....

MPJ (afro 10 vende) ose një niveli departamenti/agjencie (17 vende), që duket se ka rritur efektivitetin e kostos dhe ka minimizuar luftën për terren.

Megjithatë, ajo që duket se është mënyra më efektive për të siguruar fuqizimin e institucionit kryesor të diasporës është ose vendosja e atij institucioni brenda zyrës më të fuqishme të vendit – një shembull është Komisioni për Filipinasit Jashtë Vendit në Filipine, që është agjenci brenda Zyrës së Presidentit – ose, duke siguruar që, pavarësisht se ku vendoset institucioni kryesor, ekziston një organ dytësor ndër-qeveritar për të drejtuar politikën e diasporës dhe për të koordinuar me të tjerët. Ky rregullim i dyfishtë për shembull është në Kili dhe Meksikë.

**Në Kili,** Zyra për Kilianët Jashtë Vendit është një departament brenda MPJ-së përgjegjëse për të ofruar shërbime për diasporën dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e saj në zhvillimin kombëtar.<sup>49</sup> Por ekziston po ashtu edhe një Komision Ndërmintor për Komunitetet Kiliane Jashtë Vendit, i përbërë nga 12 institucione publike përgjegjëse për zgjidhjen e çështjeve të diasporës të cilat udhëzojnë dhe koordinojnë politikën për diasporën. Ngjashëm, **në Meksikë,** agjencia kryesore përgjegjëse për zbatim është Instituti për Meksikanët Jashtë Vendit (IME), e cila është agjenci që formalisht është pjesë e MPJ-së dhe ka një prani të madhe në terren në të gjitha konsullatat e Meksikës. Megjithatë, institucioni është mjaft i decentralizuar nga MPJ dhe qeveriset nga Këshilli Kombëtar për Komunitetet Meksikane jashtë vendit, i cili është një organ ndër-qeveritar i përbërë prej 11 ministrive.

### ***Përfshirja e diasporës në vendimarrje***

Një studim themelor mbi praktikën më të mirë në angazhimin e diasporës vlerëson se “programet kanë më shumë gjasa për sukses nëse angazhohet diaspora, qoftë drejtpërdrejt, qoftë jo drejtpërdrejt në planifikimin e tyre. Konsultimi i diasporës krijon besim dhe pronësi.”<sup>50</sup> Shumë vende e zgjidhin këtë çështje duke i mundësuar diasporës për të votuar ose madje duke flokuar vende në parlament për pjesëtarët e diasporës (14 vende). Sidoqoftë, ka shembuj të tjerë efektivë të vendeve që kanë përfshirë diasporën drejtpërdrejt në mbikëqyrjen dhe këshillimin e institucionit kryesor përgjegjës për politikën e diasporës dhe ofrimin e shërbimeve. Një rast i veçantë është **Këshilli Konsultativ i Meksikës** – një organ i përbërë nga 156 përfaqësues të diasporës i cili siguron udhëzime për Institutin për Meksikanët Jashtë Vendit (IME). Për të siguruar që Organi Këshillimor nuk monopolizohet, anëtarët zgjidhen nëpërmjet zgjedhjeve të kryera në konsullatat meksikane në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada.

### ***Sigurimi i informacionit “one-stop-shop”, shpërndarja dhe lehtësimi i shërbimeve në vendet e qëndrimit***

Shumë vende me programe të diasporës shtrijnë një varg të gjerë të shërbimeve të përkrahjes nëpërmjet konsullatave dhe ambasadave të tyre. Kjo përfshin jo vetëm përkrahjen për aktivitetet kulturore ose shërbimet konsullore, por gjithashtu informata për mundësitë për investime. Përbërja e stafit diplomatik “ka evoluar për të akomoduar nevojat dhe interesat e diasporës” dhe ekziston staf i emëruar për t’u marrë specifikisht me çështjet e diasporës.<sup>51</sup> Për shembull, çdo ambasadë e vetme **etiopase** e ka një diplomat të emëruar për t’u marrë me çështjet e emigrantëve. Rreth 70 përfaqësues të Institutit për Meksikanët Jashtë Vendit (IME) janë të vendosur në konsullatat **meksikane** dhe janë përgjegjës për zbatimin e projekteve nga IME dhe diaspora.

Çka është më e rëndësishme, një faktor kryesor është të ketë një adresë qendrore (webfaqe, institucion, etj.) që përmbledh informacionin mbi cilindo çështje me interes për diasporën: mundësitë për grante, punë, investime dhe/apo stimuj të tjerë dhe skema të përkrahjes. Webfaqja e IME-s përmban të gjitha këto informata dhe personeli i ambasadës i orienton pjesëtarët e diasporës te webfaqja. Ambasadat dhe institucionet e lidhura me diasporën angazhohen gjithashtu në shpërndarjen intensive të informatave në vendet e qëndrimit.

.....

## **Lehtësimi dhe zhvillimi mbi bazën e iniciativave inovative të diasporës**

Më lart u theksua se një prej komponentëve kryesorë të strategjisë për angazhimin e diasporës është fuqizimi i diasporës duke lehtësuar rrjetëzimit ndërmjet profesionistëve dhe duke përkrahur grupet me bazë në komunitet ose iniciativat individuale. Shumë grupe të diasporës organizohen rreth rrjeteve të biznesit, rrjeteve profesionale (p.sh. doktorët, akademikët, etj.), fondacioneve apo grupeve rajonale/tematike. Këto asociacione shpesh iniciojnë projekte ose programe të cilat shpesh janë nxitur ose shkallëzuar nga institucionet qeveritare. Përvoja sugjeron që “projektet dhe programet më të suksesshme janë ato që ngriten mbi iniciativat ekzistuese sesa ato që fillojnë rishtazi me iniciativën e qeverive”.<sup>52</sup>

Për shembull, **ChileGlobal**, është një rrjet i suksesshëm i talentit të diasporës i cili promovon zhvillimin e degëve ekonomike duke përforcuar lidhjet në mes Kilit dhe diasporës së tij. Ai qe krijuar nga Fundacion Chile, një fondacion i vogël publiko-privat. Pjesëtarët e rrjetit “kontribuojnë kohën, përvojën, kontaktet, njohuritë dhe aftësitë e tyre për ndihmuar globalizimin e kompanive kiliane”. Idetë dhe projektet e iniciuara nga këta vullnetarë lehtësohen dhe përkrahen financiarisht nga institucionet qeveritare (p.sh. agjencitë për promovimin e eksportit, ministritë, etj.) dhe deri tani rrjeti ka qenë në gjendje të krijojë 76 kompani të bazuara në partneritet ndërkombëtar.<sup>53</sup>

## **Lehtësimi i angazhimit të diasporës në diplomacinë publike**

Pjesëtarët e diasporës mund të luajnë rol të rëndësishëm në ngritjen e urave në mes atdheut të tyre dhe vendeve të qëndrimit. Kjo është arsyeja se pse shumë vende janë përpjekur të shfrytëzojnë këtë potencial duke motivuar dhe stimuluar angazhimin e diasporës duke dhënë shpërblime të rregullta dhe duke krijuar mjetet nëpërmjet të cilave diaspora mund të angazhohet.

Për shembull, Ministria e Diasporës e Armenisë ka themeluar një numër shpërblimesh dhe medaljesh dhe përkrah individët dhe organizatat në zbatimin e projekteve. MeD në Armeni lëshon pesë lloje të shpërblimeve të cilat janë tematike dhe që u jepen atyre që mbështesin dhe zhvillojnë lidhjet në mes atdheut dhe diasporës në një fushë të veçantë. Në anën tjetër, Izraeli i ofron diasporës së tij mjete që ata vetë të bëhen diplomatë. Për shembull, nëpërmjet projektit “Explaining Israel”, Ministria e Informacionit dhe Diasporës ofron informata mbi të gjitha temat relevante për objektivat e politikës së jashtme të Izraelit ose programet e vetë-trajnimit për të ngritur aftësitë dhe retorikën e komunikimit personal.<sup>54</sup>

## **Tërheqja e diasporës së kualifikuar: MIDA, TOKTEN dhe programet e vendeve të qëndrimit**

Tërheqja e punëtorëve me kualifikime të larta nga diaspora është një ndërmarrje komplekse dhe programet ambicioze që synojnë të sigurojnë të kthyerit e përhershëm në sektorë të caktuar rrallë herë që kanë qenë të suksesshme. Është e vështirë të merren si duhen stimujt meqenëse të kthyerit e përhershëm shpesh kanë nevojë shumë më tepër sesa stimujt financiarë. Sidoqoftë, ekzistojnë disa programe që në mënyrë të suksesshme kanë lehtësuar angazhimet e përkohshme të ekspertëve të diasporës nëpërmjet detyrave vullnetare ose të subvencionuara në afat të shkurtër, duke i mentoruar iniciativat, projektet e përbashkëta hulumtuese, ose të kthyerit virtual (mësimi në distancë) nëpërmjet të cilit ekspertët e diasporës fuqizojnë kapacitetet e institucioneve të atdheut dhe janë në gjendje për t'u lidhur në rrjete. Programet më të suksesshme dhe me synime zhvillime stimulojnë më tej efektet zingjirore duke financuar projekte pasuese ose duke iu dhënë pjesëtarëve të diasporës stimuj/mundësi për angazhime afatgjata ose madje edhe për vendosje të përhershme.

## **Programet MIDA në Afrikë**

Programet Migrimi për Zhvillim në Afrikë (MIDA) janë zbatuar në 11 vende afrikane dhe kanë pasur

.....

shkallë të ndryshme suksesi, me së paku tre që mundësojnë “optimizëm të kujdesshëm”. Programi ka skema të ndryshme në vendet e ndryshme por në thelb ai përkrah kthimin afatshkurtër, afatgjatë ose virtual të emigrantëve në një sektor prioritar të vendit. Programet MIDA janë zakonisht programe të udhëhequra nga komitetet drejtuese multisektoriale dhe të menaxhuara bashkërisht nga agjencitë qeveritare përgjegjëse për diasporën dhe agjencitë ndërkombëtare sikurse IOM.

Për shembull, **programi MIDA i Liqeneve të Mëdha** përkrah tri vende afrikane (Burundi, Kongo dhe Ruanda) nëpërmjet projekteve për ngritjen e kapaciteteve të zbatuara nga diaspora në sektorët prioritarë: kujdesi shëndetësor, arsimi dhe zhvillimi rural. Në më pak se tre vjet ai arriti të tërheq më shumë se 250 pjesëtarë të diasporës për të marrë pjesë në program. Vizitat fillestare afatshkurtra nga ekspertët e diasporës për trajnime, punëtori dhe/apo detyra të tjera në institucionet vendore u ndoqën nga thirrjet për propozime për projekte shumëvjeçare që rezultojnë nga vizita fillestare. Njëzetekatër projekte të tilla u vlerësuan të përshtatshme për përkrahje të mëtutjeshme.

### **Programet TOKTEN**

Programi i transferimit të njohurive nëpërmjet shtetasve të migruar (TOKTEN) u iniciua që prej vitit 1977 nga UNDP dhe është zbatuar në së paku 50 vende, “me shumë rezultate të suksesshme në vendet sikurse Kina, Polonia, Palestina, Turqia dhe Vietnam”.<sup>55</sup> Programi mbulon shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet ditore të jetesës dhe sigurimin shëndetësor për ekspertë të diasporës që janë më senior (së paku me një diplomë Master dhe përvojë pune) për t’u angazhuar në aktivitete afatshkurtra (3-6 muaj) vullnetare konsultimi në vendin e tyre, qoftë në institucione publike, private apo aktivitete hulumtuese. Pjesëtarët e diasporës krijojnë partneritet me një institucion vendor dhe aplikojnë bashkërisht për të marrë përkrahje nga programi. Një prej kufizimeve kryesore të programit ka qenë që, meqenëse i kishte si cak vullnetarët, nuk do të kishte qenë gjithmonë në gjendje për të tërhequr personat me nivelin më të lartë të përvojës.

### **Shfrytëzimi i programeve të vendit të qëndrimit: program i Gjermanisë për kthimin e ekspertëve**

Shumë prej vendeve të qëndrimit të diasporës e kanë kuptuar rëndësinë e “qarkullimit të trurit” në përkrahjen e vendeve në zhvillim por gjithashtu krijimin e lidhjeve më të fuqishme ekonomike. Gjermania – vendi me pjesën më të madhe të diasporës kosovare – është një prej tyre. **Programi i saj i kthimit të ekspertëve** është një program i udhëhequr nga Qendra për Migrim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (CIM), që nga ana tjetër udhëhiqet nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe Agjencia Federale Gjermane e Punësimit (BA). Programi përkrah ekspertët e rinj dhe me përvojë profesionale **nga një listë e vendeve në zhvillim (Kosova nuk përfshihet)** të cilët kanë përfunduar studimet ose trajnimin e tyre në Gjermani por të cilët duan të kthehen në vendin e tyre. Ai siguron shërbimeve këshillimore dhe informative deri në vendosjen dhe – varësisht nga kualifikimet – një shtesë në paga deri në dy vite, subvencione për pajisjet në punë, si dhe pajisje për udhëtim dhe transport. Që prej vitit 2004, programi ka ndihmuar më shumë se 10000 persona.<sup>56</sup>

### **Rekomandimet**

Angazhimi institucional i Kosovës me diasporën është ende në një fazë fillestare dhe eksperimentale dhe ballafaqohet me shumë sfida. Strategjia për Diasporën në shumë aspekte çon në drejtim të duhur dhe veçse parasheh një varg masash që do të zgjidhin disa prej sfidave. Por në shumë mënyra ajo është po ashtu e paqartë dhe shumë çështje mbeten të pazgjidhura, veçanërisht aspektet institucionale që do të vënin në pikëpyetje mundësinë që strategjia ose cilido program/politikë e re tjetër do të kishte sukses.

### **Stimulimi dhe lehtësimi i investimeve të diasporës**

.....

Asnjë nga masat ekzistuese ose të planifikuara nuk është e mjaftueshme për t'i zgjidhur dy problemet kryesore të rrezikut financiar dhe qasjes në shërbime më efikase të informimit dhe lehtësimit. Shumë prej shkaqeve që i bëjnë investimet më të rrezikuara nuk janë specifike për diasporën dhe duhet të zgjidhen nga reformat e përgjithshme që synojnë të përmirësojnë mjedisin e biznesit. Stimujt e planifikuar sikurse aplikimi i pushimeve në tatim ose heqja e tatimeve të tjera qeveritare vetëm për diasporën do të shkaktojnë kokëdhimbje në zbatim përderisa nuk do të kishin shumë impakt, meqenëse normat tatimore përfaqësojnë një problem të vogël në spektrin e pengesave në Kosovë (administrata është më problematike).<sup>57</sup>

Prandaj ekziston një nevojë e qartë për të zhvilluar skema të reja ose për t'i përshtatur ato ekzistuese që substancialisht mund të reduktojnë barrën financiare dhe koston e investimeve të bizneseve të diasporës. Kosova pra duhet të provojë **skemën e granteve korrespondente për bizneset fillestare të diasporës** dhe të përshtatë/shkallëzojë **instrumentin e ri të garancisë për kreditë e NVM-ve dhe skemave të kuponëve** për t'i prioritetizuar bizneset e diasporës në kriteret e përzgjedhjes. Ekziston po ashtu një nevojë për të siguruar që qasja në informim mbi mundësitë e tilla sikurse dhe format e tjera të lehtësimit të investimeve (aktualisht të siguruar nga KIESA) administrohen nëpërmjet një qasjeje më të centralizuar nga një **Shërbim i Përkrahjes së Diasporës** (do të shtjelohet në seksionin pasues për rregullimin institucional).

### **Themelimi i një skeme të granteve korrespondente**

Duke nxjerrë mësim nga përvoja ndërkombëtare, posaçërisht e Moldavisë, e cila është e ngjashme në kuptimin e madhësisë dhe zhvillimit, Kosova duhet të themelojë një **Skemë të Granteve Korrespondente (SGK)** në mënyrë që të tërheqin remitencat dhe kursimet në sektorin prodhues. Një skemë e cila do të përkrahte investimet në projektet e infrastrukturës publike do të ishte e vështirë për t'u zbatuar duke konsideruar llojet e vështirësive që do të shfaqeshin në Meksikë dhe problemin e fragmentimit/veprimit kolektiv të diasporës së Kosovës.

Programi i propozuar SGK do të ishte në dy nivele:

- 1) **Bizneset fillestare:** SGK do të përkrahte bizneset fillestare ku aksionari kryesor është pjesëtar i diasporës, ose investimet nga bizneset e diasporës që veçse kanë ndodhur në Kosovë brenda dy viteve të fundit. Kjo për shkak se pas një periudhe dyvjeçare firmat do të "bëheshin lokale" dhe të kualifikuara për skemën e granteve për NMVM-të (nëse kjo e fundit do të vazhdonte në fazën e dytë). Meqenëse këto janë biznese fillestare, grantet korrespondente nuk do të tejkalonin vlerën e 20000 eurove. Gjithsej katërdhjetë grante do të lëshoheshin për çdo vit, me faturën totale për periudhën katërvjeçare (2016-2019) që do të mbërrinte në 3.2 milionë euro (800 mijë euro për vit).
- 2) **Diaspora dhe partneriteti me firmat e jashtme:** Meqenëse shumë pjesëtarë të diasporës janë integruar mjaft mirë brenda firmave të vendeve të qëndrimit dhe janë në kontakt të drejtpërdrejtë me menaxherët dhe pronarët e firmave të këtyre vendeve, ata gjenden në pozitën më të mirë për të rënë në kontakt me mundësitë për investime dhe për të tërhequr projektet e IHD, veçanërisht nëse ata vetë e kanë një stimul. Për këtë arsye skema mund të krijojë një linjë të veçantë grantesh të dedikuara për partneritetet në mes ndërmarrësve të diasporës dhe kompanive të jashtme të dëshmuara (me së paku 10% të pronësisë së diasporës për operacionet e bazuara në Kosovë), duke u ofruar atyre një stimul financiar, për shembull për të transferuar një pjesë të aktiviteteve të tyre në Kosovë (p.sh. pjesën me më shumë fuqi punëtore ose/apo pjesën me proces të prodhimit që kërkon më pak kualifikime) ose të nisnin procese të reja të prodhimit. Këto grante korrespondente mund të jenë deri në 50 mijë euro. Do të lëshoheshin gjithsej pesë grante për vit, me faturën totale për një periudhë katërvjeçare (2016-2019) që do të arrinte në 1 milionë euro (250 mijë euro për vit).

Kriteret e pranueshmërisë në kuptimin e sektorëve do të ishin të ngjashme me këto të skemës së

.....

granteve NMVM, me shtimin e përpunimit të ushqimit, meqenëse të dhënat tregojnë se diaspora është e interesuar në këtë sektor dhe krahasimet statistikore konfirmojnë korrelacionin në mes të interesit për investim dhe prejardhjes rurale të emigrantit. Brenda një periudhe prej dy viteve firmat do të ishin në gjendje për t'u "graduuar" dhe për të aplikuar për skemën e granteve NMVM ose për të marrë hua më të mëdha me përkrahjen e instrumentit të garancisë për kreditë e NVM. Lehtësimi i investimeve do të mund të ishte pjesë e pakos dhe do të mund të ofrohej nëpërmjet **Shërbimit të Përkrahjes për Diasporën**.

Kosova veçse ka eksperiencë me menaxhimin e skemave të përkrahjes së bizneseve, duke përfshirë skemën e granteve NMVM dhe skemën e kuponëve, megjithëse për shkak të mungesës së kapaciteteve për zbatim kjo bëhet nëpërmjet projekteve të financuara nga donatorët dhe menaxhohet nga agjencitë ndërkombëtare. Skema e granteve korrespondente do të mund të zbatohet në mënyrë të ngjashme nëpërmjet një mekanizmi të tillë ose – në rastin e transferimit të plotë të menaxhimit lokal, nga KIESA dhe **Shërbimi i Përkrahjes për Diasporën**. Sidoqoftë, ajo duhet të mbikëqyret nga Komisioni Ndërmintor mbi Diasporën (do të shtjelohet në seksionin në vijim), i themeluar së fundmi dhe të këshillohet nga Rrjeti Global i Bizneseve të Diasporës dhe Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës.

### **Prioritetizimi i bizneseve të diasporës në Instrumentin e Kosovës për Përkrahjen e Kredive (IKPK) dhe Skema e Kuponëve (SK)**

Studimi i fizibilitetit për **Instrumentin e Kosovës për Përkrahjen e Kredive (IKPK)** vlerëson se ky institucion i partneritetit pritet të përkrah 47000 hua të reja gjatë 12 viteve të para të funksionimit të tij që do të mundësonin 688 milionë euro si huadhënie të reja. Ai do të siguronte mbulesë ndërmjet 50-70% të vlerës së kryegjësë së huave për huat deri në 250000 euro, për periudha deri në shtatë vite. Skema do të "përkrahte huat afatshkurtra për mbështetjen e nevojave të kapitalit punues; hua afatmesme për të siguruar asete fikse ose jofikse nga një deri në shtatë vite; instrumente për riprogramimin e kredive; blerjen e vendimeve të financimit; qiradhënien dhe shitjen e kapitalit; financimin e portofolit për institucionet mikrofinanciare dhe produktet e zhvilluara për objektiva të veçanta që synojnë gratë, grupet e cënuara, etj." <sup>58</sup> Meqenëse qeveria e Kosovës është kontribuues ndaj kapitalit iniciues të instrumentit (me 1.7 milionë euro), ajo mund të kërkojë që bizneset e diasporës po ashtu të jenë të prioritetizuara në kriteret e përzgjedhjes dhe që ata të kenë pikë shtesë në shqyrtimin e kërkesave për garanci.

**Skema e Këshillimit me Kuponë (SKK)** ofron shërbime konsulente të subvencionuara nëpërmjet lidhjeve të saj me konsulentët e certifikuar për një periudhë deri në 10 ditë konsultimi. Skema përkrah NVM-të por gjithashtu edhe bizneset fillestare dhe prioritetizon firmat me potencial eksporti sikurse dhe grupet e marginalizuara dhe në disavantazh. Bizneset e diasporës po ashtu mund të fitojnë trajtim preferencial.

**Tabela 1 - Masa e politikës #1.03.1**

Aktiviteti	Produkti	Rezultati
------------	----------	-----------

**Masa e politikës #1.03.1**  
Stimulimi dhe lehtësimi i investimeve të diasporës

Skema e granteve korrespondente bëhet funksionale në vitin 2016.

Bizneset në pronësi të diasporës përfshihen në Instrumentin e Kosovës për Përkrahjen e Kredive duke pasur trajtim preferencial.

Bizneset në pronësi të diasporës përfshihen në Skemën e Këshillimit me Kuponë duke pasur trajtim preferencial.

160 biznese fillestare dhe 20 partneritete të diasporës +firmave të jashtme investojnë së paku 8.4 milionë euro në katër vite fiskale 2016-2019.

Afro 100 firma në pronësi të diasporës marrin garanci për kredi në periudhë katërvjeçare 2016-2019

Rritje e investimeve të diasporës në sektorët produktivë

Krijimi i vendeve të punës

Efekte zingjirore për IHD të tjera

## Krijimi i një kornize institucionale efektive për angazhimin e diasporës

Nevojitet një qasje më e guximshme për të zgjidhur problemet që rezultojnë nga arkitektura e tanishme institucionale që merret me diasporën. Këto masa duhet të ndihmojnë në ndërtimin e besimit në raportet në mes diasporës dhe institucioneve të Kosovës dhe të përmirësojnë ofrimin e shërbimeve duke fuqizuar kapacitetet, harmonizuar ofrimin e shërbimeve në vendet e qëndrimit, duke fuqizuar MeD-në për të udhëhequr politikën dhe programimin e aktiviteteve dhe duke rritur përfshirjen e diasporës në vendimarrje.

Duke u bazuar në përvojat e Kilit dhe Meksikës, Kosova së pari dhe para së gjithash duhet të themelojë një **Komision për Diasporën** i cili do të udhëhiqej nga Ministri i Diasporës por që do bashkë-kryesohej nga Zyra e Kryeministrit dhe një përfaqësues i Kuvendit të Përgjithshëm të Diasporës. Ky do të ishte organi qendror për zhvillimin dhe koordinimin e politikave dhe programeve të diasporës. Komisioni do të përbëhej nga të gjitha ministritë e qeverisë si dhe të gjitha agjencitë e tjera që në çfarëdo mënyre janë relevante për ofrimin e shërbimeve për diasporën. Kuvendi i Përgjithshëm i Diasporës dhe Rrejtji Global i Bizneseve të Diasporës (dy institucione që janë në proces të themelimit) do të shërbenin si organe këshilluese për Komisionin. Kjo mënyrë rregullimi do ta vinte në pozitë MeD-në që të angazhonte institucionet e tjera në mënyrë efektive përderisa do t'i jepte diasporës një zë në platformën qendrore të politikëbërjes.

Kosova po ashtu duhet të themelojë një departament të veçantë brenda MeD-së, **Shërbimin e Përkrahjes për Diasporën (SHPD)**, i modeluar pak a shumë sipas Institutit për Meksikanët Jashtë Vendlindjes (IME) që do të ofronte shërbime të drejtpërdrejta lehtësuese për diasporën në vendet e qëndrimit. Udhëheqësi i SHPD-së do të raportonte drejtpërdrejt në Komisionin për Diasporën dhe do të kishte një komunikim të drejtpërdrejt (pika të kontaktit) me një varg institucioneve qeveritare sikurse KIESA, Ministria e Punëve të Jashtme, Doganat e Kosovës, etj. SHPD do të kishte një autoritet qendror dhe personel në Prishtinë por shumica e stafit të tij do të vendosej në ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendet ku ka prani të madhe të diasporës, kryesisht Gjermania (3), Zvicra (3), Italia (1), Austria (1), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (2), MB (1), Sllovenia (1), Turqia (1) sikurse dhe Beneluxi (1) dhe vendet skandinave (1). Shërbimi pra do të kishte një prani në terren të njerëzve të tij.

Disa nga detyrat dhe funksionet kryesore të shërbimit do të ishin:

- Ofrimi i informacionit, udhëzimeve dhe lehtësimit për diasporën për sa i përket programeve dhe mundësive për t'u angazhuar në Kosovë (projektet, stimujt, etj.), duke përfshirë llojet e shërbimeve të lehtësimit të investimeve të ofruara nga KIESA.
- Zhvillimi dhe menaxhimi i webfaqes interaktive të SHPD-së që do të përmbante të gjitha informatat mbi shërbimet dhe stimujt e ndërlidhur me diasporën.
- Organizimi i përpjekjeve për të komunikuar me diasporën.
- Menaxhimi i drejtpërdrejtë i programeve specifike për diasporën (p.sh. iniciativat për transferimin

e aftësive).

- Menaxhimi i skemave të granteve dhe projekteve specifike për diasporën në vendet e qëndrimit nëpërmjet thirrjeve për aplikime në sferat e: kulturës, diplomacisë publike, etj.
- Mirëmbajtja e bazave të të dhënave të pjesëtarëve të diasporës, shoqatave, rrjeteve, iniciativave, etj.
- Lehtësimi i lidhjeve dhe përkrahja e rrjeteve të bizneseve të diasporës dhe shoqatave të diasporës.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e një pakoje të diplomacisë publike për pjesëtarët e diasporës për t'i angazhuar si ambasadorë joformalë të Kosovës.
- Koordinimi i përpjekjeve për diplomaci publike bashkërisht me Zyrën e Presidentit dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, duke përfshirë identifikimin dhe propozimin e pjesëtarëve të diasporës të cilëve do t'u jepeshin shpërblime për përpjekjet e tyre, do të emëroheshin ambasadorë dhe do të përkraheshin në projekte dhe aktivitete.

Kosova po ashtu duhet të sigurojë që rregullimi i ri institucional është i ndërlidhur me **përpjekje serioze për ngritjen e kapaciteteve**, mundësisht duke u siguruar për një program të financuar nga donatorët që do të rriste kapacitetet dhe sigurote trajnime të vazhdueshme në bashkëpunim me shërbimet e ngjashme ekzistuese në vendet e tjera. Po ashtu, duhet të kemi parasysh përfshirjen e implikimeve buxhetore në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Ministria e Diasporës ka një buxhet vjetor prej afro 1.6 milionë euro për vit të planifikuar në periudhën 2015-2017. Krijimi i SHPD-së, i cili do të mund të bëhej nëpërmjet një ristrukturimi të brendshëm do të kërkonte punësimin e së paku 25 pjesëtarëve të rinj të stafit (10 vendorë dhe 15 të vendosur jashtë) do të rriste linjën e tanishme buxhetore të MeD-së për pagat e planifikuar për afro 500000 euro në vit dhe 2 milionë euro për periudhën 2016-2020. Zgjerimi i shërbimit fillimisht do të mund të testohet në dy vendet me praninë më të madhe të diasporës, do të thotë Gjermaninë dhe Zvicrën (6 përfaqësues).

	Aktiviteti	Produkti	Rezultati
<b>Masa e politikës #1.03.2</b>	Ligji për Diasporën dhe udhëzimet administrative modifikohen për të reflektuar strukturën e re institucionale, posaçërisht krijimin e Komisionit për Diasporën dhe Shërbimin e Përkrahjes për Diasporën.	Administrimi politikëbërës dhe programimit të aktiviteteve bëhet më përfshirëse, e harmonizuar dhe efektive	Rriten investimet e diasporës në Kosovë
<i>Ngritja e kornizës institucionale efektive për angazhimin e diasporës</i>	Komisioni për Diasporën themelohet deri në mesin e vitit 2015 duke përfshirë të gjithë akterët relevantë.	Bizneset e diasporës marrin informata dhe lehtësim të shërbimeve mbi investimet nga SHPD.	Diaspora ndihet që më shumë pronësi mbi procesin e vendimmarrjes
	Departamenti i Shërbimit të Përkrahjes për Diasporën bëhet plotësisht funksional brenda MeD-së deri në vitin 2016, duke përfshirë gjashtë zyrtarë në terren në GJER dhe ZVI.	Pjesëtarët e diasporës marrin më shumë informata mbi mundësitë e angazhimit në vendet e qëndrimit	

**Tabela 2 - Masa e politikës #1.03.2**

### **Lehtësimi i mundësive për angazhim afatshkurtër për diasporën me kualifikime të larta**

Kosova duhet të fillojë një program, i modeluar sipas programeve MIDA në Afrikë dhe të zbatohen nga Shërbimi i Përkrahjes për Diasporën, që do të përkrahte iniciativat e diasporës për angazhime afatshkurtra në Kosovë por gjithashtu edhe përpjekjet për të siguruar efektet zingjirore duke: a) duke ofruar grante pasuese shumëvjeçare për iniciativat/projektet që do të rezultonin nga këto aranzhime dhe b) ofruar lehtësim dhe stimuj për zgjidhje afatgjatë për të diplomuarit e programit dhe të kthyerit

.....

e tjerë me kualifikime të larta.

Sa i përket detyrave afatshkurtra, llojet e shërbimeve që mund të përkrahen nëpërmjet këtij programi, që potencialisht quhet **Programi për Angazhim të Atdheut (HEP)**, janë ofrimi i përkrahjes financiare dhe lehtësimit (shërbime informimi, korrespondimi, etj.) për angazhim sikurse:

- Detyrat afatshkurtra nga akademikët: projektet bashkëpunuese të hulumtimit me institucionet e atdheut, punëtoritë, ligjëratat, etj.
- Praktikrat profesionale nga studentët e rinj të diasporës ose ekspertët junior në institucionet publike dhe private në Kosovë.
- Angazhimet verore afatshkurtra për studentët e diasporës në projektet e komunitetit.
- Angazhime të subvencionuara të ekspertëve me kualifikime të larta teknike në firmat e sektorit privat në Kosovë për të përkrahur zhvillimin e proceseve të përmirësuar të prodhimit ose ofrimin e shërbimeve.

Një komponent tjetër i politikës së transferimit të aftësive do të mund të ishte iniciimi i një programi **TOKTEN** nëpërmjet Vullnetarëve të Kombeve të Bashkuara (UNV) për detyra vullnetare afatshkurtra në institucionet publike ose private të Kosovës, si dhe të lidh Kosovën me **Programin e Kthimit të Ekspertëve** në Gjermani – destinacioni më i madh i migrimit – meqenëse, është për çudi që Kosova është një nga vendet e vetme në rajon që aktualisht nuk përfiton nga programi. Shërbimi i Përkrahjes së Diasporës do të sigurote ndarjen e informatave dhe lehtësimin e këtyre programeve, duke përfshirë udhëzime mbi mundësitë e tjera të angazhimit sikurse Programi për Kthimin e Trurit (nëse vazhdohet) dhe Fondi i Kuadrove.

**Tabela 3 - Masa e politikës #1.03.3**

**Masa e politikës #1.03.3**

*Lehtësimit afatshkurtër i mundësive për angazhimin e diasporës*

Programi për Angazhim në Atdhe (HEP) bëhet funksional deri në vitin 2016

Kosova kualifikohet për Programin e Kthimit të Ekspertëve në Gjermani deri në vitin 2016

Kosova dhe UNV iniciojnë programin TOKTEN për vullnetarët e diasporës

Në periudhën 2016-2019 HEP përkrah

- 50 detyra afatshkurtra nga akademikët e diasporës
- 200 praktika profesionale për ekspertët junior
- 100 angazhime nga ekspertët teknikë me kualifikime të larta në firmat private
- 40 projekte pasuese nga të diplomuarit e HEP
- 50 pjesëtarë të diasporës përfitojnë nga Programi për Kthimin e Ekspertëve
- 50 vullnetarë angazhohen nëpërmjet programit TOKTEN

Institucionet publike kosovare dhe firmat private rrisin kapacitetet e tyre për shkak të transferimit të aftësive.

Forcohet lidhja në mes Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës me kualifikime të larta

Një numër i pjesëtarëve të diasporës me kualifikime të larta kthehet në mënyrë të përhershme në Kosovë



.....

## **Tabela e figurave**

Figura 1 - Rritja e PKB real në Kosovë dhe në vendet e qëndrimit të diasporës kosovare në % .....	6
Figura 2 - Statusi i punësimit i të kthyerve kundrejt statusit të punësimit të joemigrantëve .....	9
Figura 3 - Gjetja e punëtorëve të kualifikuar është një vështirësi serioze (% e firmave, sipas sektorit të prodhimit).....	9
Figura 4 - Pema e problemit të mobilizimit të diasporës.....	14


## **Lista e tabelave**

Tabela 1 - Masa e politikës #1.03.1 .....	21
Tabela 2 - Masa e politikës #1.03.2 .....	23
Tabela 3 - Masa e politikës #1.03.3 .....	24

## Referencat

- <sup>1</sup> **International Organization for Migration (IOM) and Migration Policy Institute.** "Developing a Roadmap for Engaging Diasporas for Development: A Handbook for Policy Makers and Practitioners in Home and Host Countries." 2012
- <sup>2</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>3</sup> **Kosovo Agency for Statistics and United Nations Development Programme.** "Study on Remittances 2013." 2013.
- <sup>4</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>5</sup> **Kosovo Agency for Statistics and United Nations Development Programme.** "Study on Remittances 2013." 2013.
- <sup>6</sup> **Kosovo Agency for Statistics and United Nations Development Programme.** "Study on Remittances 2013." 2013.
- <sup>7</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>8</sup> **Kosovo Agency for Statistics and United Nations Development Programme.** "Study on Remittances 2013." 2013.
- <sup>9</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>10</sup> Ibid.
- <sup>11</sup> **Kosovo Agency for Statistics and United Nations Development Programme.** "Study on Remittances 2013." 2013.
- <sup>12</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>13</sup> **3CIS Company Website.** Link ><http://www.3cis.net/?module=Page&action=show&id=17>
- <sup>14</sup> **BBC News.** "Kosovo's wines flowing again". 2011. Link ><http://www.bbc.com/news/world-europe-15401459>
- <sup>15</sup> Intervistë me udhëheqësin e 3CIS.
- <sup>16</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>17</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>18</sup> <http://digjitale.com/2014/04/one-companys-perspective-self-destructive-government-practices-impact-economic-growth-kosovo/>
- <sup>19</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>20</sup> **International Organization for Migration (IOM) and Migration Policy Institute.** "Developing a Roadmap for Engaging Diasporas for Development: A Handbook for Policy Makers and Practitioners in Home and Host Countries." 2012
- <sup>21</sup> Intervistë me biznesmen dhe aktivistë të diasporës.
- <sup>22</sup> **International Organization for Migration (IOM) and Migration Policy Institute.** "Developing a Roadmap for Engaging Diasporas for Development: A Handbook for Policy Makers and Practitioners in Home and Host Countries." 2012.
- <sup>23</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>24</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>25</sup> **Kosovo Agency for Statistics.** "People on the Move: An Analysis of International, National and Local Mobility of Kosovo's People." Link ><https://ask.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/People-on-the-move-ENG.pdf>
- <sup>26</sup> **World Bank.** "Migration and Economic Development in Kosovo." 2011.  
Link >[http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Migration\\_and\\_Economic\\_Development\\_in\\_Kosovo\\_WB\\_report.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Migration_and_Economic_Development_in_Kosovo_WB_report.pdf)
- <sup>27</sup> **United Nations Development Programme.** "Human Development Report 2012: Private Sector and Employment." 2012
- <sup>28</sup> **Ministry of Trade and Industry and United Nations Development Programme:** "Sector Profiles" 2014.  
Link ><http://www.mti-ks.org/en-us/Publications>
- <sup>29</sup> Intervistë me udhëheqësin e 3CIS.
- <sup>30</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Remittance Study 2012". 2012
- <sup>31</sup> **Iseni, Bashkim.** "Balkan Diasporas in Switzerland: Historical Role, Constraints and Opportunities for Development"  
<http://ebookbrowse.net/bashkim-iseni-pdf-d220554052>
- <sup>32</sup> Intervistë me aktivist të diasporës.
- <sup>33</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>34</sup> **Economic Initiative for Kosovo (EIKS).** Link ><http://www.eciks.org/en/about-us>
- <sup>35</sup> **Encouraging Young Entrepreneurs (EYE).** Link >: <http://eye-ks.com/en>
- <sup>36</sup> **Kosovo Diaspora Initiative.** Link >: [www.kosovodiaspora.org](http://www.kosovodiaspora.org)
- <sup>37</sup> **United Nations Development Programme.** "Kosovo Human Development Report 2014: Migration as a Force for Development". 2014
- <sup>38</sup> **"Pogragja" Association.** Link ><http://www.pogragja.com/>
- <sup>39</sup> **World Bank Institute.** "Diaspora Networks and the International Migration of Skills: How Countries can Draw on Their Talent Abroad." 2006. Retrieved from: <http://siteresources.worldbank.org/KFDLP/Resources/461197-1122319506554/DiasporaIntro.pdf>
- <sup>40</sup> Intervistë me përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.
- <sup>41</sup> **Diaspora for Development.** "SWOT Analysis: Diaspora and Kosovo Institutions." 2012

- .....
- 
- <sup>42</sup>**EC-UN Joint Migration and Development Initiative (JMDI)**. Contribution to the GFMD paper, “Mainstreaming Migration in Development Planning — Key Actors, Key Strategies, Key Actions” (background paper, session 1.2, Athens, November 2009).
- <sup>43</sup>**Financial Markets International (FMI)**. Kosovo Credit Support Facility. 2014. Link ><http://www.fmi-inc.net/news/news.html>
- <sup>44</sup>**International Organization for Migration**. Kosovo MSME Grants Scheme. 2014. Link ><http://kosovo.iom.int/support-microsmall-and-medium-enterprises-kosovo-msme-grants-project>
- <sup>45</sup>Ibid.
- <sup>46</sup>**Association of Regional Development Agencies**. “Award Ceremony for the Best Business Plan Competition UNDP/DEED project. Link ><http://arda-kosovo.org/en-us/news/Award-Ceremony-for-the-Best-Business-Plan-Competition-UNDPDEED-project-86>
- <sup>47</sup>**SciDev**. “Kosovo’s Diaspora unmoved by Brain Gain Fund”. Link ><http://www.scidev.net/global/education/feature/kosovo-s-diaspora-unmoved-by-brain-gain-fund.html>
- <sup>48</sup>Intervistë me përfaqësues të partisë politike.
- <sup>49</sup>**International Organization for Migration (IOM) and Migration Policy Institute**. “Developing a Roadmap for Engaging Diasporas for Development: A Handbook for Policy Makers and Practitioners in Home and Host Countries.” 2012.
- <sup>50</sup> Ibid.
- <sup>51</sup> Ibid.
- <sup>52</sup> Ibid.
- <sup>53</sup> Ibid.
- <sup>54</sup>**Xharra, Behar and Martin Wahlisch**. “Beyond Remittances: Public Diplomacy and Kosovo’s Diaspora”. Foreign Policy Club, 2012.
- <sup>55</sup>**International Labour Organization**: TOTKEN Programmes. Retrieved from: [http://www.ilo.org/dyn/migpractice/migmmain.showPractice?p\\_lang=en&p\\_practice\\_id=26](http://www.ilo.org/dyn/migpractice/migmmain.showPractice?p_lang=en&p_practice_id=26)
- <sup>56</sup>**Center for International Migration and Development (CIM)**. Returning Experts Programme. <http://www.cimonline.de/documents/CIM-Flyer-prf-en.pdf>
- <sup>57</sup>**Maliqi, Agon and Dren Pozhegu**. “Impact of Tax Regime on Manufacturing Sectors in Kosovo”. United Nations Development Programme in Kosovo. 2014.
- <sup>58</sup>**United States Agency for International Development (USAID)**: “Kosovo Credit Guarantee Facility Feasibility Study. 2012. Retrieved from: [http://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PA00JM49.pdf](http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PA00JM49.pdf)
- .....



## KU MUND TË MARRIM MË TEPËR INFORMATA?

Procesi i përgatitjes së PLAN-it është koordinuar nga  
Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit.

Për më tepër informata mund të kontaktoni në:  
[info@plan-rks.org](mailto:info@plan-rks.org)

[www.plan-rks.org](http://www.plan-rks.org)